

BIBLIOTEKA

8JH-1

A 66

DHORI QIRJAZI

Kuz zemža

żteh sé paži...

Lirika

20

5

98-102

TIRANË, 1958

DHORI QIRJAZI

35642

SA - 1
Q: 66

~~22768~~



BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

Kur zemra rreh së pari...

LIRIKA

TIRANE, 1958

Redaktor: N. JORGAQI

Tirazhi: 1.000

Stash: 2204-55

Shtypur në Stabilimentin «MIHAL DURI» — Tiranë, 1958

G J U R M A T

Rri mendoj... Përjashta drurët
i rreh era, bën tufan,
në zjarrishtë ndizen urët,
në dritare lot një xham;
fill i vetëm jam në dhomë
shkruaj vargje. Si vegim
kalëruar shoh Heronë
malesh ngjet e sokëllin!

Ja, më ngjan se rreh me shpatë
mbi të artën yzengji,
ndërsa kali lelegjatë
zhduket grykash si veri.
Dhe stërgjyshët kordhëtarë
varg e varg i shkojnë pas,
er' e vjeshtës duke ngarë
pelerinat u ngre pas...

Për betejë bie briri
edhe trupin të rrënqeth,
dridhen malet ndaj të gdhiri
dhe luginat rreth e rreth...
turren trimat mbi bregore,
pirgut tutje si një hon,
edhe shpata mbi tabore
e gjakosur vringëllon!

Dhe Ay në majë fare
përmbi shkëmbin mijvjeçar,
ngre të rëndën përkrenare
sheh kufoma, gjak e zjarr
kryethinjur leshlëshuar;
ndërsa kali perçezi,
shfryny i ndezur i tërbuar
përmbi ushtat mizëri.

E si pret e grin pa masë
mbi të huajën hordhi,
i flet kalit lelegjatë,
i flet kalit perçezi,
dhe doriu i harbuar
u vërsul porsi rrufe
dhe nga pirgu, shkumbëzuar,
u hodh lart e ra përdhe!

Dhe ku shkeli në ata gurë
gjurmën la e u nis tej ⁽¹⁾ . . .
u drodh pylli plot me drurë,
u drodh' ujrat në lumej,
u ndal era e tërbuar,
u ndal shqipja në ajri,
ndërsa trimi kalëruar
ngjitej grykash përsëri . . .

Shkuan vite qysh ahere,
shkuan shekuj, miqt' e mi,
që kur malesh me pëttere
shkoi e Tija ushtëri,

1) — Në Mat diku është dhe sot një gjurmë kali skali-
sur mbi një shkëmb, që i thonë «Gjurm' e kalit të Skën-
derbeut».

por atje përmbi rrëpirë
gjurm' e kalit ësht' dhe sot,
gjurm' e kalit perçengrirë
e të madhit Kastriot.

Vjeshtë, vjeshtë; jashtë era
i rreh drurët, bën tufan;
në zjarrishtë ndizen urët
në dritare lot një xham;
gjindja ra në ëndërrime
mua gjumi nuk më zë,
era fryn, oh, sa kujtime
ndjell un sonte një nga një.

Ish kështu e fundit vjeshtë . . .
frynte erë dhe tufan;
në katundin tim të thjeshtë
ndjeva hapin partizan,
dollëm rrugës të shikonim
rrugët zbardhnin plot me gas,
ata shkonin e këndonin,
rrugës gjurma linin pas . . .

Kishte rënë bor' e parë
kishin ikur zogjtë larg;
ata ecnin të pandarë
prapa kodrash varg e varg;
ne i shihnim të gëzuar,
(rruga zbardhët plot me gas)
ata shkonin e këndonin
rrugës gjurma linin pas . . .

Vjeshtë, vjeshtë! Er' e rreptë
turret shtigesh shpat më shpat,
zjarri digjet qet' e qetë
jam në dhomë fillikat,

prap ndjej marshe, rri pa gjumë
rrug' e gjurma përsëri . . .
un' mendoj . . . edhe çdo gjurmë
më rrëfen një histori!

B A L T A

Prap erdhi vjeshta . . . shi dhe erë . . .
rrëket' e pyllit prapë erdhë,
përbalte rrugët dhe një herë
o balt' e verdh', o balt' e verdhë!

Të sjell ndërmend baltë . . . baltë . . .
kur shkuan trimat armët ngjeshur,
i ndoqe pas me dit' më natë,
u qulle këmbët gjysmë çveshur . . .

Me ta ti fjete në llogore
kur bor'e ngrirë thurte flokët,
me ta u shkrive ndër kasolle,
me ta dhe kur mbulovë shokët.

E gjakn' uritur, ah ti thithe
rrëket nga plagët kur u derdhë,
po sa e dashur për ta ishe
o balt' e kuqe, balt' e verdhë!

M A L E T

«Dikush më tha një ditë duke qeshur:
i dua fushat e blerta pa kufi,
s'i dua malet gjithnjë me mjegull veshur,
se ku ka male ka dhe varfëri.»
«Po t'ish kështu o male s'do t'ju doja,
po un' ju dua, ju dua pse e di:
se ku ka male ka edhe shqiponja,
se ku ka male ka dhe krenari!»

P È R G J I G J A

Hej thëllënix' e malit
fushës na ka dalë
ku kalon një lumë,
me të rreptat valë,
pa më ngjitet lart
nëpër gjetherina,
ku bleron tërfili,
te hapet lëndina,
plot me trëndëlina.

Ngjitet vasha lart
lark e tret vështrimin
tej në ato male,
ku përçolli trimin,
e sjell nëpër mënd
ditët pranverore,
kur shetisnin bashkë
në këto bregore:
zënë dora-dore.

Ah, sa fjalë trimi
vashës i pat thënë
ndër këto lëndina
një natë me hënë . . .
tek rrinin të dyzë
afër një mullari
u digjej krahrori
porsi flakë zjarri,
oh, si flakë zjarri!

Po që atëhere
vite kanë shkuar
dhe sa herë vasha
trimin ka kërkuar,
po ay s'u kthyë
më në këto dhera . . .
sa vjet e ka pritur
moj kjo zemr' e mjera,
oh, kjo zemr' e mjera!

Hej, thëllënix' e malit
fushës na ka dalë
ku kalon një lumë,
ku buçet një valë,
sheh si rritet gruri,
sheh si rritet bari,
bletën nëpër lulet
ngjyra-ngjyra zjarri
velur nga nektari.

I thërret djaloshit
sa lëkunden brigjet,
por ah, zër' i tija
vashës s'i përgjigjet,

s'i përgjigjet vashës
më ky zër' i djalit . . .
larg veç val' e lumi
ç'po shkrepej pas zallit,
haj, thëllënxit e malit!

I ka hedhur sytë,
vetullakurorë
nga fushat e gjera
fushat plot traktorë . . .
diku ndër kodrina
ku kullot një grigje,
tek lodrojnë shqerrat
ndër sheshe e brigje
edhe merr përgjigje.

Dielli zuri malë,
pyjet plot blerime,
nëpër mënd i vijnë
vashës sa kujtime . . .
sa vite kaluan
me shi e shtërgatë,
sa eshtra u tretë
në një pyll të thatë,
oh, bujkesh e ngratë!

Vreshtat janë veshur
gjethet po blerojnë
edhe zogjt' e qiellit
bukur ligjërojnë,
po vilastar i prerë
shumë pat lotuar
si bujkesh' e gjorë
që ia dredh aq shtruar,
zëmërpërvëluar . . .

Dička do tē thotē
dička s'e mban dōt
dhe nga syr' i bukur
i rrēshqet një lot;
lot' i ndezur flakë
zjarr' i çupērisë . . .
po e pret fshatarja
lotn' e dashurisë
në çip tē shamisë.

Prite moj fshatare
në çip tē shamisë
lotin që tē ndezi
zjarr' i dashurisë;
atje n'ato vreshta
mos e lër tē bjerë
në gōtēn e gazit
mbushur plot me verë,
mos e ler tē bjerë!

Po nē varr tē trimit
ti mbill një hardhi
ta kujtojë botā
gosti mē gosti
hej, thëllēnx' e malit
kaqë vjet pa pjekur
qëndro si qëndrove
shpirt e zëmër hekur
trimi yt s'ka vdekur!

ERA E LULEVE

Kujtimit të gjyshes.

Ndër mënd e sjell un' gjyshen mirë
kur delnim në obor;
kish leshrat mbushur plot me thinjë
e qeshte si me zor.

Ajo shpesh tirte lesh në drugë
e ulur përmbi fron,
un' losja pak më tej në rrugë
e ngrija një ballon.

Më mbante shpesh ajo në prerë
më thosh ndonjë të re:
si: «kur fryn era në pranverë
ësht' er' e luleve».

Edhe shpesh herë rrinte heshtur,
nuk bënte zë ajo;
ç'më thoshte gjyshja, duke bredhur
i shpija un' kudo.

Mirpo një dit' tek shisnja mëndje
një shoku im ma pat:
more, — më tha, ashtu me ëndje —
sa koh' kjo erë zgjat?

Un' s'dinja gjë, po me shpejtim
e zura gyshen fill,
ajo më tha: «o biri im,
kjo fryn vetëm në prill».

Edhe tek brithja ndër lodrime,
në shok' e miqësi,
u thosha s'ka si gjyshja ime,
të gjitha ajo i di.

Kujtoj un' gjyshen; rri i heshtur,
frym erë në shëndre,
shikoj për qark, çdo gjë e qeshur,
frym er' e luleve.

Dhe po të kisha gjyshen gjallë
do shkonja prap me vrap,
t'i thosha: gjyshe, ç'ësht' kjo vallë
shpjegimin s'di t'ja jap.

Ajo, e di, do thoshte prerë:
ësht' er' e luleve,
pa çka se frym ajo n'pranverë
e s'resht as në shëndre.

Ndër mënd e sjell un' gjyshen time
të ulur përmbi fron,
ndërsa dëbora jasht' me thinjë
çdo dru e zbardhëllon.

Dhe tek mendoj un' gjyshen plakë
frym erë mbi konak,
dhe më e ngroht' më ngjan kjo flakë
që digjet në oxhak.

Po më vjen keq për gjyshen time
që s'rrojti edhe më,
se prap' frym er' e luleve
e ndjej un' prap' atë.

Oh, le t'i fshejë rrezet dielli
kështu pra ndodh tek ne:
frym er' e luleve në prill,
po s'resht as në shëndre!

NDODHI NË FSHAT

Në fshatin tim të largët n'ato shkrepë
postjeri shkoi një ditë plot me shi,
përndau me radhë letra e gazeta
e rrug' të gjatë mori përsëri.

E si gjithnjë si kan' zakon fshatarët
pran' portës sime u mblohdë një nga një,
kurse ay që mbahet mbi shkollarët
filloi gazeten ta lexonte me zë.

Shpesh her' aty me fjalë ngryset dita:
për politik', për shkenc' e përparim,
por këtë her' ashtu si për të gjitha
po bisedonin edhe për emrin tim.

E nëna ime që vinte shpesh vërdallë
të mbyllë, aty viçokun me pahir,
tek po dëgjonte, habitej, ç'të jet' vallë,
gazeta flet kështu dhe për tim bir?

Edhe la viçin të hidhet bishtpërpjetë
më afér shkoi, ç'ish kjo, të pyes' desh,
i than': yt bir ka shkruar në gazetë,
por ajo prap asgjë nuk mori vesh.

Nuk shkuuan dit' më erdhi mua letra:
«më shkruaj bir, më shkruaj se nuk di;
çfar ish ajo që shkrojte në gazeta,
a ishe ti ay a s'ishe ti!...»

Edhe në çast ashtu me vehten time
e vura buzën në gas un' kot më kot,
porse pastaj më mbytën ca mendime,
më erdhë sysh ngadal' dy pika lot.

Ehe, o nën' ti ndoshta ke të drejtë,
që ta kuptosh këtë ti e ke zor:
të jesh fshatar të shkruash në gazetë
dhe aq më shum' të bëhesh vjershëtor ! ? . . .

MËNGJES NË FSHAT

O mik' e bukur, zbardhi tek ne drita,
cijasin zogjtë të mardhur në çahir
e lumi rrjedh . . . ,
o fshat për ty u ngrita,
të flas me mall,
të flas me gaz e hir!

T'i desha ty dhe pyje dhe gorica,
suka të ndara e diellin në agim,
të artën vjesht',
e shpesh të tuat ngrica,
të parat bula të kumbllës në shpërthim.

Po mbi gjithçka të desha këtë ditë,
këtë mëngjes;
shpalosur si flamur,
kur kënga rrjedh si kroi mbi koritë,
diku argjënd,
diku i kuq purpur!

Zhurmojnë rrugët;
gjindja shkon në punë
si vllaj me vlla, si shokë e si miq,
o ç'harmoni!
o erë fryj ndër drurë
e këtë varg e shpjer si sihariq!

Le të përzihet me këngën kënga ime,
në rrug', në fush'.
në pyllin larg atje,
ku zgjohet toka veshur avullime,
ku rrezja zjarr përflak një tufë re.

Mëngjes, mëngjes!
u shkri e holla brymë . . .
dëbor' e bardh', një mjegull ra mbi lumë . . .
Shikoni miq! Gjithçka sikur merr frymë!
Sa shum'e vlen ta duash jetën shumë ! . . .

Dhe tek sodis hapsirat plot me dritë,
mëngjes' e art shpalosur si flamur,
rrjedh kënga tej
si ujrat mbi koritë . . . ,
oh ç'mrekulli!
si lumi gur më gur ! . . .

FSHATI RADONESH

Male, male, ah' e lisa,
rrotull si kurorë,
rrjedhin ujrat, bëjnë zhurmë
shtigjeve me borë.

Larg pyjet mjegullohen
rrjedh diku ujvari,
sipër shkëmbit i mahnitur
ndalet udhëtarë.

Shikon tutje: pyje, drurë,
dorën vë mbi ballë,
humbin rrugët, kreshtat treten
porsi në përrallë.

Male, male kryethinjur
çuka midis resh,
midis tyre mezi duket
fshati Radonesh.

Tutje duken tē shpérndara
lisave tē lashtë,
ca shtëpi tē bëra guri,
ca kasolle kashtë.

Sipér tyre shkëlqen vesa
si argjënd i hollë;
zémërçelur këtu njerzit
shpirtin pa një njollë!

Këtu flladi fryn i lehtë
grykave gjithmonë,
ndërsa dimri vërshon shpejt
dhe pranvera vonë.

Malet gunën zën' e shkundin
vishen në tē kaltër,
ndërsa krojet shpesh nga larg
feksin si albastër.

Dhe në ardhësh këtej pari
ku shpesh flenë retë,
mos harro nga këto pyje
tē rrëmbesh një fletë.

Dhe kudo që tē vravosh ti
për kujtim ta kesh;
nuk ka gjethe më tē blertë
se në Radonesh.

Male, male, ah e lisa,
rrotull si kurorë,
rrjedhin ujrat, bëjnë zhurmë
shtigjeve me borë.

35642

22768

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIRKASTER

NJË KUADER

Tej duket ahishtja e blertë
dhe lumi që ecën plot valë.
Ngadalë
në rrugën e ngushtë
po ecën një plak;
Driadat vallzojnë ndër fletë.
Plaku ngre shkopin,
sheh gardhin e kalbur ka rënë
psher'tin e ulet ngadal' te sinori.
Traktori
nxjerr tym më përtej
e fushën me brazda e pret
kryq e tërthori!

KUADER VJESHTE

Noton mjegulla mbi lumë,
er' e rreptë tej buçet;
pyll' i çveshur ra në gjumë,
mbrëmj' e qetë ja ku zbret ...

Noton mjegulla mbi lumë,
vjesht' e lagur hyn në fshat;
bariu del në mal me gunë,
pleqtë s'duken në sçfat...

NE BRI TE KAUT

Në fshat të largët në mes ahut
ku rrjedh burimiëmbëlsisht,
na shkoi një dit' me çantë krahut
djalosh i ri elektriçist.

Nuk kishte gjë me vehte miku
tek ecte rrugës në zabel,
përveç se llamba elektriku
edhe kordon e fije tel.

E pritën mir' atë fshatarët
i bënë drek', i bën' gosti,
pastaj ay ndër më të parët
te gjyshi Trik shkoi në shtëpi.

Një drit' i shpuri drejt në vatër,
një tjetër odës pak më von',
ndërsa pas pakë si për hatë
i vuri një dhe mbi ballkon!

Dhe plakut Trik i queshte nuri
e mikut pran' i thosh her' her';
«do shkojm' pastaj dhe tek ahuri
atje ku un' punoj shtalijer!»

E kur mbaruan aty punë
në shtallë shkuan dhe atje,
edhe atje, të lumtur, shpunë
këtë të madhen drit' të re.

Por sa kaluan jasht te praku
sikur ra gjyshi n' èndërrim:
«ore, s'i vure tha së paku
dhe një në bri balashit tim ! . . . »

E nuk e mbajtën dot gëzimin,
tha buzëgaz djalosh'i ri:
«po t'ish nevoja do t'ja shpinim
dhe kaut një dritë përmbi bri.»

E përmes fshatit poshtë ahut
ku rrjedhin ujrat èmbëlsisht,
djaloш e gjysh të zën' prej krahut
prap' diç rrëfenin miqësisht ! . . .

RADIO TIRANA

Fryн' er' e çmëndur pyjesh fare shkretë,
çdo shteg u zu, çdo rrugë s'pipëtin,
më s'duket yll dhe hëna ra ndër retë,
veç tej krenar hidrocentrali ndrin.

Në muzg tanë dhe kodrat janë struktur,
një zgë diku i mardhur cicëron;
një vals po jep Radio-Tirana bukur
e ngjan se fshati i tërë po vallzon.

Frym' er' e qmëndur, çirret si ulkojë,
çdo shteg u zu, çdo rrugë s'pipëtin,
Tirana larg vazhdon të transmetojë
e tej krenar hidrocentrali ndrin!

VALLJA E VASHAVE

Vallen dor' për dore
sa bukur e dridhni,
o zemra rinore,
pëllumbesha moj, vallen dor' për dore.

U prin mu në ballë
një sorkadhe fushe
yll o yll i rrallë,
një çapkënkë moj, u prin mu në ballë.

E merrni rrëmbyer
e mbani ngadalë,
mesin më të thyer,
vogëlushe moj, e merrni rrëmbyer!

Dylbenkat shpalosur
i dridhni në duar
vallen më të sosur,
kapedane moj, dylbenka shpalosur!

Ndezur nga gjëzimi
dikujt i rreh zëmra
kur pas i vjen trimi,
kur pas i vjen trimi, njërsë ç'mi rreh zëmra.

Pa shpejton më shumë
t'i dal' valles mbanë
e shkel si furtunë,
vogëlçsh e bukur ç'na shpejton më shumë!

Dridheni m'u lumtë
vallen vajzërore!
nesër ne do zbresim
poshtë në fushore, poshtë në grurore . . .

Poshtë në grurore
vallen më të zjarrtë,
kështu do ta heqim,
kështu do ta heqim, zënë dor' për dore!

NJEQIND KRUSHQ

Thellë grykat fshehin rrugët
porse kreshtat gjë s'i mban;
nëpër prozhm' e në të mugët
një kalorës ngjet revan.

Shtatë qafa la mënjanë,
shtatë male i la pas;
bri borigash, një murane
kal' i lëdhur na iu qas.

Hingëlliti si i marrë
ndërsa rrugën ndiqte drejt,
e kalorsi duke parë
shapkën hoqi shpejt e shpejt.

Rrug'e ngushtë ngrinte pluhur,
poshtë shkëmbit rridhte prroj
e, kalorsi duke u sulur
kalin lehtas fshikulloi.

E si pa se duall yjet
çoi mustaqen pash më pash,
ndërsa gjakun nëpër pyje
e lëshoi avash-avash.

Ish i lëdhur, i kapitur
u ndal pakë në pillat,
ndërsa Lera e dremitur
vezullonte në një shpat.

Eh, pillat, pillat i bardhë
rridhte uj' a ridhte ar, . . .
ardhur çupat radh' e radhë
gjith' çemberët me qenar.

Ndali plaku i krekuar;
shpejt u hodh mbi yzengji:
kujt i qeshte syr' i shkruar,
kujt i qeshte syr' i zi?.

U hoq plaku pak më lartë
këmbën hodhi gju mbi gju;
eh, pillat, pillat i artë,
lum kush mbush në krojt' e tu.

Edhe shapkën vu mënjanë
si çapkën njëzet vjeçar,
pa vështronte aty pranë
mesn' e hollë lozonjar.

Eh, kjo vajzë vetullpisë
←— as më thua e kujt je?»
←— Jam e Basho Lerallisë»
foli Baca sy përdhe.

Rrëmbeu stomat nëpër duar
dhe bucelën me zinxhir,
foli plaku: «merre shtruar,
jam tek juve mysafir.»

Nëpër rrug' e nëpër bllaca,
ajo iku si veri;
ç'i pëlqeu Këratit Baca
ta kish nuse në shtëpi.

«Që t'i gjeje nuse djalit
pata bredhur fshat më fshat,
duket kjo thëllënix' e malit
paska qënë më për fat.»

Dhe këmbeu ay paranë,
piu te Bashua mysafir,
zbrazën pushk' e këngë thanë:
«le të jetë me ahir!»

Dhe nuk shkuan disa javë
dikush erdhi në shtëpi,
s'ishte plak, por ishte djalë,
ishte dhëndri mbi dori.

Dhe kështu kaluan muaj,
erdhi vera përsëri,
u poq gruri, u lidh duaj,
u vu bari ndër qipi.

U mbyll Baca te shtëpiza
zëmra i dridhej plot me shënd,
natën thurte çërap në shtiza,
ditën thurte n'avëlmënd.

Po një dit' i shkoi një shtrigë
vajzës njomë në kënak
leshrat varur bigë-bigë
edhe sytë si me gjak.

I tha: shih, mendohu mirë,
ku do shkosh e mjera ti,
atje jan' kooperativë.
s'kanë tok' e s'kan' shtëpi.

Dhe sikur ta kish pickuar
gjarpri fshehur nëpër gjeth,
ajo shtangu pikëlluar,
shtat' i njomë iu rrënqeth.

Edhe Bashua zëmërhoesh,
kur dëgjonte vesh më vesh,
— s'ësht' e mundur të martohesh
— tha — kur tokë të mos kesh.»

se dhe ara do sinuar,
se dhe kopshti do kufi,
ndaj te krushku kish dërguar
me dikë një porosi.

Na i thoshte: «Gjel Korata,
mos më shkelni më në prak,
s'e jap çupën n'ato fshatra,
ku gjith' han' në një çanak.»

Gjel Korata leshrathinjë
shapkën uli përmbi sy;
dërgoi letër: «do të vimë,
proto vjeshtë jam aty.

Bacën vishe në të bardha,
kujdes Bacën të ma kesh.»
Dhe mustaqet dredha-dredha
na i ngriti përmbi vesh.

Pa na ngriti fshatn' e tërë
proto vjeshtë me një zë,
njëqind krushq i vuri sërë,
dhëndëri njëqнд e një.

Ndër zabele frynte era
pyllit tutje me duvak;
«pritna, pritna Basho Lera
ne që ham' në një çanak.

Bishtin prapa e ka dardha
mëndjes sonë do të vish,
Bacën vishe në të bardha,
nuse Bacën ti ma vish.»

Dhe u nisën varg përpjetë
nëpër pyjet veshur ar,
eci, eci dit' e netë
ky karvani buçimtar!

Shtatë qafa la mënjanë,
shtatë male lanë pas,
gjersa nisën për matanë
brushtullukët plot me gas.

U tund Lera, tërë fshati
nëpër ah' e nëpër dushq:
erdhi, erdhi Gjel Korati
jo më pak se njëqind krushq.

E si erdhë të harbuar,
çanë rrugët mes për mes;
pastaj këngën muar shtruar
gjer u gdhi u bë mëngjes.

Diku ndihej një lahutë,
kuajt shfrynin lart ndër dushq;
ku ke par' o Basho çupën
të martosh me njëqind krushq?

Dhe s'u bë jo gjëm' e madhe,
kur shkoi nata, kur u gdhi:
nusja hipi kalit bardhë
dhëndri hipi mbi dori.

KENGË GAZMORE

(Sipas një motivi populor).

Aman millona,
kurban millona.
grurët të ma bluash
fare për sevda,
çasmë neve kemi
millona më qafsh
ta bluash të butë,
të butë mëndafsh!

Aman vogëlushe
lërmë mos më nga;
m'u lëshua vija
diku atje la,
ujë s'vjen një pikë,
ujë moj më duhet:
guri më s'vjen rrotull
gruri nuk të bluhet.

Aman millona,
kurban millona,
ujët ta zë unë
ty mor atje la,
veç ti e di vetë.
për mërak e ke:
ta bluash të butë
si për gjysleme¹⁾!

Aman vashëzo,
vashëzo kurban;
radha është zënë,
radhë për ty kam,
veç më thuaj moj,
thuam ti moj ti,
vallë kush martohet
se dua ta di?!

Buzëqeshi vasha
qeshi me zë pakë,
ndezur në fytyrë
bërë posi flakë;
pastaj ngriti synë
fjalët më s'i zgjati.
«Ç'të duhet, mor xhaxho,
një vajzë nga fshati!»

1) Llojëmbëlsire = bakllava.

As aman-aman
ç'dasmë do të kemi,
ujët do na vijë
këngës do t'ja themi,
grurët do ta bluaj
nesër mój të vish;
po, pér ty thëllëzë
radhën kush s'e prish?!

TRAKTORISTI DASHURON

Ndër pemishte, ndër mullarë,
këndon zogu pikalosh;
shkëlqen vesa nëpér arë,
ndez traktorin një djalosh.

Ndez traktorin i shpejtuar,
lëshon plugjet edhe nget...
se tej ledhit një syshkruar
buzëqeshur diç i flet.

Porse vasha më nuk priti
veç i tundi një shami,
dhe pastaj luginës zbriti
ku ndrit kroji si inxhi.

E nuk deshi as përgjigje,
gjë djaloshit s'i kërkoi,
u fsheh tutje nëpér shtigje
porsi era fluturoi.

E djaloshi djersët lumë
ballin fshiu e tha medet:
— fushat kanë rrugë shumë
duhesh ngarë dhe më shpejt.

Dhe traktorin zëmëruar
ay brazdës prap' e ktheu,
veç një zjarr i pakuptuar
zëmrën fshehtas ja rrëmbeu . . .

* * *

Digjet zëmra, shkrihet vetë,
oh, çfar zjarr që qënka ky;
nuk të lë një çast të qetë,
nuk të lë të mbyllësh sy!

Eh, djalosh që rri pa gjumë,
pse më kot brengosesh ti;
fushët kanë rrugë shumë
pa takuar s'lën njeri!

N D O S H T A ! ?

Rrugës tej në mugëtirë
vështroi gjyshja nja dy njerës,
i pandehu mysafirë
pa u ngrit nga pragu i derës.

Shpejt e shpejt e shtroi shtëpinë,
(u kapit e gjora plakë),
tha: — «tani mirse të vinë,
gati jam t'u bëj dhe darkë.»

Ndezi dritën. E shpejtuar
dhe njëherë pa së largu:
ata erdhë fare shtruar,
po pse vallë mben' te pragu?

Priti, priti gjysh' e gjorë
po pastaj tha: — «diç do jetë,
portës miqtë s'rrin' një orë,
duhet shkuar t'i marr vetë!»

Dhe ashtu si do zakoni
sy e buz' në gaz i shpuri:
— eni miqt e mi, urdh'roni,
po u pres, — tha — kam qëkuri!

Sa dëgjuan se kush thirri,
çifti iku, u bë erë;
ndoshta tutje nga çairi,
ndoshta në një tjetër derë.

Edhe plaka fërkoi sytë,
mbeti shtangur si e ngrirë:
«ata ishin vet' i dytë,
apo un' s'i pashë mirë!?»

Do t'i kishte ndjekur prapa,
tej rrugicave me drurë,
po ç'e do s'i bënin hapat
e s'i zinte dot më kurrë.

Dhe sikur të merrete ndjesë
vështroi yjet ngjyr' floriri,
kërkoi zotit t'i thërrësë,
as atija nuk i thirri!

Ndaj u kthye. Errësirë . . . ,
diku hëna ra ndër retë . . .
ç'kujtoi gjyshja mysafirë,
ndoshta ishin djalli vetë ! ? . . .

* * *

Zën' e ndizen yjet, nat' e qetë bie,
këngën që nis djali era larg e shpie.

Vasha del dritates e vështron mbi mal,
sikur do t'i thotë hënës; dil të dal.

Derdhet muzgu i kaltër, hëna yjet ndjek,
eh, kjo këngë malli zëmrës ç'i troket!

FLUTUROI NJË VARG ME PATA . . .

I

Fluturoi një varg me pata
në zabelet kodrinore
ah, ju pata, ah ju pata,
sollët erë prej dëbore!

Pa del vasha në drithore
hapi vasha dy kanata;
në zabelet kodrinore
fluturoi një varg me pata . . .

II

Dergjen drurët në thëllime,
zogjtë çerdhet kanë lënë;
diku largë në marshime
trimin bora ç'e ka zënë.

Netë, netë, yje e hënë,
bie vasha në mendime
trimin bora ç'e ka zënë
diku largë në marshime!

III

Fluturoi një varg me patë,
zun' e treten togje bore;
si kandili kur vjen nata
digjet zemra vajzërore.

Pret djaloshin në dritore,
pret ajo në dy kanata . . .
zun' e treten togje bore
zhduket tej një varg me patë . . .

OH KUR LEMZA TË TË MARRË

Oh, kur lemza të të marrë,
do vështrosh në largësi
zall më zall e ar' më arë
gjer këtu në malësi,
gjer këtu në malësi,

Oh, kur lemza tē tē marrë,
do më sjellësh nëpër mënd,
kur na gjente ndër mullarë
drit' e hënës si argjënd,
drit e hënës si argjënd ...

Do më shohësh ti në shtigje
natën roje tek qëndroj;
nëpër çuka, nëpër brigje
tej pér tej tek vigjëlloj,
tej pér tej tek vigjëlloj.

Oh, kur lemza tē tē marrë,
në mëngjes a natën von',
ta dish ti, kurrkush më parë
se sa unë s'të kujton,
se sa unë s'të kujton!

NJË MERAK QË KAM ...

1

Po zverdhohet gruri,
qershia po piqet;
një merak që kam
nga zëmra s'më hiqet.

2

Iku vap' e verës,
er' e vjeshtës fryri;
fluturaken time
më s'ma zuri syri.

Po afrohet dimri,
 pylli nis e thahet...
 një merak që kam
 nga zëmra s'më ndahet!

NËN OMBRELLË

Një ditë vjeshte kisha dalë
 po ecja vetëm nëpër shi,
 po binin gjethet dalngadalë
 në rrugë s'dukej asnjeri.

Përveç një vajzë lagur shpellë
 po çante ujrat si më not,
 i thash: «urdhroni nën ombrellë
 përsë të lagesh kot më kot!»

E shiu sikur t'ma dinte hallin
 filloj të binte si rrebesch,
 megjith'se vajza rrudhi ballin,
 më erdhi pranë deshi s'desh.

Vazhdonte shiu si me shtambë
 e rrugët erdh' u bënë det;
 qëndruam ne, e pastaj ramë
 në një të ëmbël muhabet ...

Sa ndënijëm ne të bisedojmë
 t'u them të drejtën nuk e di:
 po sa her' thosh ajo të shkojmë
 i thosha un': «po bie shi.»

Dhe ndodh, o miq, që nën ombrellë
kur ke se çfar të bisëdosh,
nga këmbët mund të lagesh shpellë
dhe prap' nga rruga të mos shkosh!

C'MENDON, O RRUGË!...

1

C'mendon, o rrug', tej pyjeve të lashtë
kur muzgu sjell mbi gjethë p'ka lot,
mos për atë që shkon në kreshta lartë
e prapseprap' me yj s'takohesh dot?

2

C'mendon, o vajz', kur rri e sëdit hënën
a kur qëndis me fije një shami,
mos për atë që do t'i falësh zëmrën
dhe nuk e njeh dhe ende nuk e di?

* * *

Vajzës që desha në vogëli.

I vogël isha, qiellin për çdo natë
vështroja rreth e bija n' ëndërrim...
un' desha yjt' e yllin më të zjarrtë
një mbrëmje gjeta; e qoja yllin tim.

E desha yllin si pyllin e çairë,
si bar' e njom' e valën me vërtik,
gjithnjë atij i lija lamtumirë
kur gjumi qet' më vinte mbi qerpik.

Një natë prap vështrova qiel e artë
rrëke me yj... Sa vite mbenë pas!...
e pash' me mall un' yllin tim të zjarrtë
tek futej thell' në detin plot tallaz.

Ashtu dhe ty o vajz' të desha shumë,
të mbaja pran', lodronim tok gjithnjë,
po shkuan vjet, në rrugë prap breth unë
po të kërkoj, por ah, s'të gjej dot më!

NATË DASHURIE

Ndër fjolla resh dremitur ecën hëna
e muzgu ra, mbështelli malet rreth;
të kam ty pran', sa fortë më rreh zëmra,
e ndjej diçka që trupin ma rrënqeth.

Askush s'na di ku jemi këtë natë,
ku breshim ne s'na di më asnjeri;
sa bukur ësht' të rrish mbi gjethn'e thatë
kur pylli plak zë vishet në flori.

Ne ndalim pak' nën gjethin e këputur
e hëna lart nɔton ndër fjolla resh;
sa bukur ësht' që veç me një të puthur
magjin' e saja natës t'ja rrëmbesh!...

* * *

O dashuri e parë, o mituri e shkuar,
sikur t'na kthenje, flladn' e ëmbël përsëri ...
pse erdhe kur ne s'dinim të bënim dashuri,
pse ike kur u dogjëm në zjarr të përvëluar?!

* * *

Po çvishen sallgamer plot fletë
dhe bryma ka rënë ndër ara,
ja rruga ka mbetur e shkretë,
ku lamë takimet e para,
dhe gjethet zvarrisen të mjera
të thara, rrëmbyer nga era.

S'do lëmë më rrugës takime
sallgami do heshtë i gjorë,
do dridhet në er' e thëllime,
do thinjet nën flokët me borë,
por prap ay gjallë do mbesë
dhe ne përgjithnjë do na presë!

Frym erë, po çvishen sallgamer
e shiu troket nëpër xhamet!
Frym erë dhe trupi të ngjethet
ja rruga ka mbetur e shkretë ...
veç ndjenjat nuk bien si gjethet,
veç ndjenjat nuk thahen si fletë.

* * *

Dhe vera shkçon dhe zogjtë larg mërgojnë
dhe gjeth' i blert' zverdhohet në të ftohtë
dhe pyllin plak zën thinjët e mbulojnë,
kur dimri vjen me erëra, me shqotë!

Gjithçka kalon. Dhe vjeshta e trishtuar
dhe dimr' i bardh' me erëra, me shqotë,
kur di se shpesh dikush e dëshëruar
mendon për ty, po, veç për ty në bëtë!

* * *

Të desha ty, kur desha edhe yjet
dhe malet varg dhe mjegullat dhe pyjet.

Po shkojnë vitet... Do vij' e fundit orë
të mbylliim sytë. S'ka gjë pse s'vum' kurorë.

Kurora jon' çka bota në kët jetë:
yje, male, baltë, drur' e fletë!

* * *

Kur të vij çasti e dashur ndonjëherë
të kesh në dorë së pari këtë varg,
do bjerë shi, do fryje ndoshta erë,
do jem për ty, do jem un' aq larg!...

Në shtrat do kesh një tjetër n'ato netë,
që s'të kuption, që brengën nuk ta di,
do derdhç me frik' pastaj dy lot të nxehëtë
mos zgjosh atë t'i ngjallësh xheloz!

Dhe në u zgjoft' e di se ç'do të thuash:
«mos u shqetso se isha n' ëndërrim;»
do mbyllësh syt' e ëndrrën do ta ruash,
të gjall' ashtu me lot gjer në agim.

Oh, sa të desha! s'po të vë në rimë
se në çdo varg je ti dhe vetëm ti,
më fal në vij të prish un' qetësinë
dhe s'jam aty që lotët të t'i fshij!

V J E S H T È ...

Oh, lamtumir, o këndi im i thjeshtë,
po shkunden gjethet e arta rrëth e qark;
frym' er' e ftoht' moti gjëmon larg
e bryma endet mbi ara e mbi vreshtë!

Me koh' dhe pyll' i thinjur zu të heshtë,
rrëke e turbull rrëzohet përmbi zall...
oh, lamtumir, o këndi im i rrallë,
mirse na vjen në fshat e arta vjeshtë!

E bukur je, pa çka se ngre stuhinë
e tufa resh në qiell' e kaltër mbledh,
pa çka se drurët i le ti pa një gjeth,
e kreshtave nis derth të ftohtat thinjë!

GJURMA LOTËSH

(Motiv kurbeti)

I

Zunë yjet rrallëtojnë
ksenatarët zun' e shkojnë.

Muarr yjet arratinë,
hën' e zbehtë ra në det,
niset djali lë shtëpinë,
niset burri në kurbet.

Frym' e frys thëllim' i ngrirë
përmbi male ngre tufan;
zgjohet fshati që pa gdhirë,
ja ku niset një karvan ...

Del një nuse në dritare
dhe karvanin ndjek me sy ...
doshta mbesin larg për fare,
ndoshta s'shihen më të dy!

Dhe karvani duke ngarë
pluhur, brëngë pas seç lë;
oh, dy zemra ç'paska ndarë
ndoshta, ndoshta përgjithnjë.

Frym veriu, papandehur
nis e shuhet yll' i ri,
dhe dy lotë më të fshehur
seç u mblodhën në shami.

Niset djali lë shtëpinë,
niset burri në kurbet,
muarr yjet arratinë,
hën' e zbehtë ra në det!

*Pret atë që s'vjen
dhe një dhimbje ndjen.*

O e mjera unë dhe sa do ta pres
trimin që më iku gjer në zogjt' e zes? ¹⁾
oh, sa vite shkuan, mjer'o un e mjera,
shkoi çupëria, shkoi dhe pranvera,
 oh, pranvera ime!

Nëpër breg të detit shumë her' kam shkuar,
tej në hapësirë valët kam vështruar;
deshë që t'i pyes, desha t'u thérres,
me zjarrin e zëmrës që në gji mu ndes,
 oh, me përvëlime!

Deshë t'u thërrisja: valë o ju valë
më këputi malli, më thoni një fjalë:
ju na kini ndarë, ju do na bashkon,
o ju valë detesh që vini e shkoni,
 rron ay a s'rron?!

Vala nis e shtrohet, hëna zbret mbi det,
tej në hapësirë një katart humbet ...
dhe në breg të detit mbi një shkëmb po rri
një sorkadhe malesh me duar në gji
 diçka èndërron ...

Valët ven' e vinë, valët vin' e shkojnë
mbi detin e kaltërt valët zhurmërojnë
herë turren vrullshëm, herë me ngadalë
herë shkumbëzohen, her' shkasin si ngjalë
 si mendim' i saj!

Oh, sa nat' e bukur kjo nata me hënë
kur gjith' shpeshëria në gjumë ka rënë,

1) Populli e ka për shumë larg n'Amerikë = qrapa diellit

veç një ëngjëllushe vetëm paska mbetur
me syrin e bukur diku largë tretur,
haj, o vashë haj!

Dhe përmbi zallishte vala shushurit
me sy të përlotur vasha pëshpërit:
o e mjera unë dhe sa do ta pres
trimin që më iku gjer në zogjt' e zes,
dhe sa do ta pres?!

ENIGMA E MBRETTIT

Fije nga një përrallë.

Na ish njëher' një mbret me emër të dëgjuar,
jetonte në mes arit e lluksit përrallor,
ku derdhet Eufrati¹⁾ pallatet pat ndërtuar,
çfar kishte dheu i tërë kish sjellë në obor.

Çdo ditë vdisnin njerëz për mbretin kryelartë,
kurorës që t'i shtonin më tepër dhe një gur
e pinte i kënaqur gjithnjë në kupë t'artë
nga deti kur i sillnin dhe perla dhe punpur . . .

Por veç dikça atë s'e linte kurr' të qetë:
kur mbrrinte gjer në kulm të qefit ndër gosti,
me eshtra njerzish ndezur i shkruhej ngjyrë zbehtë:
«Manel Thekel Fares»⁽²⁾ mbi muret ar safi.

1) Lumë në Persi.

2) — Ora e fundit po të afron.

Orakuj, filozofë na thirri pranë mbreti;
gjith' njerzit më të ditur-shpjegime desh nga ta;
porse mbishkrim' i zjarrtë gjithnjë enigmë mbeti
dhe n'e kuptoj ndonjeri prej frike nuk ia tha.

Ahere mbreti thirri përpara gjith' njerëzinë;
të dinte të vërtetën, ish bërë kureshtar,
enigmën kush ta gjente në tërë mbretërinë
për të ay do mblidhte një tog të madh me ar!

Po njerzit bashk'u mblodhën e thirrën: «E kuptuam!»
e zëri u ngrit lart si dallga përmbi det,
e zëmrën me shtigjet atij mërisht ia shpuan
i thanë: «kjo ësht' zgjidhja në gjuhën ton' o mbret!»

P O E T I

Poeti i do dhe kreshtat shkëmb e gurë,
të kaltrin qiell dhe pyjet plot me drurë,
çdo fije bar, dhe erën edhe shinë
dhe detin tej rrëmujë në tallaz,
oh, shpirti tij sa ngjet me vetëtimën
dhe këng' e tij-gjëmimit që vjen pas!

HISTORI

Lexoj, në kopsht, un' historinë,
për rreth më qesh i émbli maj,
ja, kam pérpara lashtësinë
spartanët — luftrat me Persinë,
qëndroj një çast e fryshtë mbaj...

Mëngjes i artë — fryshtë veriu,
veriu fryshtë pérmbi Tomorr...
në mënd më vinë si vetiu
Omar Khajami — Firdusiu,
oborr' i Shahut përrallor.

Lexoj, o miq, pér lashtësinë,
edhe më thellë fryshtë marr!
shikoj të mjerët, skllavërinë,
në brigje tej Aleksandrinë,
ku ngrihet lart e lart një far!

Pérjashta maj' bleron i qeshur
lexoj plot èndje histori...
korijet, kopshtet janë veshur;
si lumë koha rrjedh pareshtur
e kurrë s'kthehet përsëri!

E un me libër dit' pér ditë
dhe mote, shekuj i pérshkoy,
lexoj pér Majin¹⁾ plot me drithë,
pér mbretër — shtatë mrekullitë,
pér trima, luftra pér fajkoj!

1) Festa ndërkombëtare e punëtorëve.

Po në se mburret bot' e vjetër
përveç me shtatë mrekulli,
ne që përbysim frone, mbretër,
ne që ndërtojmë jetë tjetër,
po shkruajm' tjetër histori!

Dhe do lexojnë nipat tanë
ashtu si unë çdo mëngjes:
për njerëz trima si luanë,
për flamuj pune an' e mbanë,
për dritë, maj e pér kongres!

Dhe do të shohin të mahnitur
çdo hap të jetës pas kësaj.
Partin' e Punës lartë ngritur,
si far i ndezur rrezendritur,
që prin e duket në çdo skaj!

DUKE DËGJUAR BETHOVENIN

E dua Gëten, Bethovenin më shumë,
ku gjuh' të njëjtë gjeti e gjith bota;
krenar ay; pér 'të do thosha unë:
o histori të shprehu me shtatë nota!

O histori, me shkopin e argjentë
ti shekujsh shkon e ngre ndër ta stuhi,
a nuk je ti vet' «Sinfoni e nëntë»,
a nuk je ti ky tingull plot magji?

FENIKS (1)

Unë digjem... më sheh ti për së largu
po s'jam qiri, nuk derdh, jo, pika lot!
dëgjomë ti, në tingujt varg pas vargu,
një zëmër rreh që do diçka të thotë.

Unë digjem, por jo si meteor
që ngjet me zhurm' në qiellin pa kufi;
un' jam Feniksi, zogu përrallor;
që vehten djeg të bëhet prap' i ri!

1) — Feniksi — zog mitologjik, që ndjek vehten për t'u
përtërirë.

PASQYRA E LËNDËS:

Faqe

1) Gjurmata	3
2) Balta	6
3) Malet	7
4) Përgjigja	7
5) Era e luleve	11
6) Ndodhi në fshat	13
7) Mëngjes në fshat	14
8) Fshati Radonesh	15
9) Një kuadër	17
10) Kuadër vjeshte	17
11) Në bri të kaut	18
12) Radio — Tirana	19
13) Vallja e Vashave	20
14) Njëqind krushq	31
15) Këngë gazmore	26
16) Traktoristi dashuron	28
17) Ndoshta!	29
18) «Zën e ndizen yjet»	31
19) Fluturoi një varg me pata	31
20) Oh, kur lemza të të marrë	32
21) Një merak që kam	33
22) Nën ombrellë	34
23) C'mendon, o rrugë	35
24) «I vogël isha»	35
25) Natë dashurie	36
26) «O dashuri e parë»	37
27) «Po çvishen sallgamet plot fletë»	37
28) «Dhe vera shkon»	38
29) «Të desha ty, kur desha edhe yjet»	38
30) «Kur të vijë çasti»	38
31) Vjeshtë	39
32) Gjurma lotësh	40
33) Enigma e mbretit	42
34) Poeti	43
35) Histori	44
36) Duke dëgjuar Bethovenin	45
37) Feniks	46

LIBRA TË REJA

1 — Poezi	H. HAJNE	50
2 — Fati njeriut (Tregim)	M. SHOLLOHOV	10
3 — Komedи të zgjedhura	K. GOLDONI	50
4 — Gropat e rrugës (Tregim)	V. TENDRIAKOV	10
5 — Letra të padërguara	A. KUTUJ	15
6 — Muzgu (Roman)	HAN SER JA	30
7 — Luftanija e pavdekëshme (Tregim)	E. JUNGA	10
8 — Tania revolucionare (Tregim)	E. VEREJEVSKAJA	